

Data _____.2026

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“Ndërtim i Veprës së Marrjes dhe Zgjatim i Kanalit të Darsisë Njesia Adm- Gjocaj”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45000000-7 - Punë ndërtimi,

VLERA E FONDIT LIMIT:

212,452,299.51 (dyqind e dymbëdhjetemilion e katerqind e pesëdhjetë e dymije e dyqind e nentëdhjetë e nente pike pesëdhjetë e nje) leke pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Peqin ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Procedura perzgjedhese e prokurimit qe do te perdoret ne kete tender eshte percaktuar sakte ne urdherin e prokurimit:"Tender i Hapur".

Procedura e prokurimit eshte mbi kufirin e ulët monetar dhe nen kufirin e lartë monetarë

Në përputhje me nenin 33 të LPP kufijtë monetarë janë:

a) Kufiri i lartë monetar:

- 528.781.400 (pesëqind e njëzet e tetë milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e një mijë e katërqind) lekë për kontratat e punëve publike;

- 13.699.000 (trembëdhjetë milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë) lekë për kontratat publike të shërbimeve dhe mallrave.

b) Kufiri i ulët monetar:

- 12.000.000 (dymbëdhjetë milionë) lekë për kontratat e punëve publike;

- 10.000.000 (dhjetë milionë) lekë për kontratat publike të shërbimeve dhe të mallrave.

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT OFERTUESI DEKLARON SE:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);

c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të percaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërket për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërket për Operatorët Ekonomikë, të regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 8.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme përvërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe nenit 26 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenet 76, 82 dhe 83 të LPP dhe Nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Kërkesat e mësipërme janë detyruese dhe i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për të krijuar bindjen e tij se operatorët ekonomik pjesëmarrës ushtrojnë veprimtarinë e tyre konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, përmbushin kriteret ligjore për të marrë pjesë në procedura prokurimi si dhe kanë shlyer të gjitha detyrimet tatimore dhe ato të energjise elektrike sipas percaktimeve të legjislacionit përkatës.

Po ashtu, paraqitja e sigurimit te ofertes eshte detyrim ligjor i percaktuar nga legjislacioni ne fuqi mesipercituar, si nje mjet garancie per AK ne rast te tërheqjes së ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave; refuzimit për nënshkrimin e kontratës së prokurimit apo mosparaqitjes së sigurimit të kontratës, kur oferta është shpallur fituese, ose mosplotësimi të ndonjë kushti tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas përcaktimeve në Kriteret e Përgjithshme të Perzgjedhjes / Kualifikimit pika 1 e Shtojcës 7

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2023,2024,2025) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit).*Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe Nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Referuar në Nenin 29 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore” “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: *“Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej **50 milionë lekësh**; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej **100 milionë lekësh**; iii) ka, mesatarisht, **30 të punësuar** gjatë periudhës kontabël”*

2.2.2 Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (2023, 2024,2025) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet konkretisht: **212,452,299.51 leke pa tvsh** Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në Nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe në Nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*. ku përcaktohet se: *” Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar”*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Lloji i procedurës është “E Hapur – Punë Publike - ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar – Prokurim publik me mjete elektronike”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të Nenit 43, pika 2, gërma ”a” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*, ku përcaktohet se: *”Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar*

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi

Përcaktimi i vlerës së kërkuar të xhiros (jo më e vogël se vlera e kontratës) është brenda marzhit të lejuar që mund të kërkojë. Gjithashtu për të stimuluar të gjithë operatorët e rinj që operojnë në treg si dhe për rritur numrin e konkurrentëve në këtë procedure është gjykuar që vlera e xhiros së kërkuar të jetë minimalisht sa vlera e parashikuar e kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Nenin 43, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”* ku përcaktohet se: *”Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklarave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe,*

sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2026 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Argumentimi. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likujduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore

Kjo kerkese eshte vendosur me qëllim që AK të ketë mundësinë të shohë nëse OE pjesmarrës kanë apo jo detyrime ndaj NJ.Q.V, fakt që tregon fleksibilitetin e tyre financiar

Njësia e prokurimit përcaktoi kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart, duke qënë se këto kriteret janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

3.1 Aftësitë teknike dhe profesionale:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

1. Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo me te vogel se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: **106,226,149.76** lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.
- b. Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo me te vogel sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: **424,904,599.03** lekë pa TVSH.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

3.1.1 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular vleresimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular vleresimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim;
 - Fatura tatimore perkatese.

3.1.2 Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontraten e Bashkimit të operatorëve ekonomik si dhe prokurën e posacme të deklaruar në fazën e tenderimit.

3.1.3 Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: kontratën bazë ndërmjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor, kontratën e nënkontraktimit dhe aktin e miratimit zyrtar si nënkontraktor.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77** të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale**. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Pika 4.Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.”

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: “*pika 5. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.*

Pika 8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Njësia përcaktoi kriteret për punë të ngjashme si më lart duke qënë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës.

Sipas këtij neni, Njësia e prokurimit vlerëson se duhen kërkuar disa prej dokumentacioneve ligjore të zbatimit të punimeve, bazuar në Ligjin Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit” (i ndryshuar), si dhe akteve në zbatim të tij, pasi duke qënë se kontrata për punë publike që po prokurohet është në bazë të punimeve me matje, sipas nenit 39 pika 1/a e VKM-së, lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës krahas dokumentacionit të përcaktuar në nenin 39 pika 5/a dhe b, të paraqesin dhe kontratën e sipërmarrje, aktin e kolaudimit, situacionin përfundimtar, certifikaten e marrjes në dorezim të përkohshëm/përfundimtar si dhe formular vlerësimi për punët e kryera me entet publike, për të patur mundësi të bindet nëse operatori ekonomik zotëron përvojën e nevojshme për zbatimin e kontratës, ku punimet e mëparshme duhet të kenë zëra të konsiderueshme punimesh me zërat e punimeve që po prokurohen, si dhe në rastin kur punimet e mëparshme janë kryer si bashkim operatorësh ekonomikë, nuk jepet informacion mbi përqindjen e anëtarëve në bashkim, në vërtetimet që lëshojnë autoritetet kontraktore dhe në faturat tatimore të shitjes, ku këto të fundit lëshohen nga përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ekonomikë.

Meqënëse paraqitja e dokumentacionit të mësipërm, nuk sjell diskriminim dhe/ose kosto shtesë për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, por i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e përvojës së duhur të tyre, duke mundësuar zhvillimin normal dhe në kohë të procedurës së prokurimit, pasi nuk ka nevojë që Autoriteti të kërkojë informacione shtesë gjatë vlerësimit të ofertave (në rast mungese të informacionit të sipërcituar), njësia e prokurimit gjykon se kërkimi i dokumentacionit përcaktuar në kushtin e mësipërm është i nevojshëm për vërtetimin e kryerjes së punëve të ngjashme.

Gjithashtu është kërkuar:

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontraten e bashkimit të operatoreve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë: Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, është kërkuar edhe paraqitja e kontratës së bashkimit të operatoreve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE, mbështetur në parashikimet e nenit 88 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.**

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtarë, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”

Me anë të këtij dokumentacioni autoriteti kontraktor ka mundësi të njihet me vlerën reale të punimeve të realizuara nga ofertuesi/t, mbi bazën e një kontrate të realizuar si BOE.

Referuar natyrës së kontratës për punë publike, njësia vlerëson se duhen kërkuar disa prej dokumentacionit ligjor të zbatimit të punimeve, bazuar në ligjin Nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit” (i ndryshuar), si dhe akteve në zbatim të tij, pasi duke qënë se kontrata për punë publike që po prokurohet është në bazë të punimeve me matje, sipas nenit 39 pika 1/a e VKM-së, lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës krahas dokumentacionit të përcaktuar në nenin 39 pika 5/a dhe b të VKM-së, të paraqesin dhe kontratat e sipërmarrjes, situacionet përfundimtarë, si dhe Faturat Tatimore sipas legjislacionit në fuqi, për të vërtetuar faktin, nëse operatori ekonomik pjesëmarrës zotëron eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor është kërkuar edhe miratimi nga ana e autoritetit kontraktor, si nënkontraktor i deklaruar, në respektim të parashikimeve të nenit 89 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Pra, dokumentacioni i kërkuar si më sipër, është kërkuar me qëllim që AK të përlogarisë vlerën e saktë të kontratave të mëparshme të realizuara nga ofertuesi, brenda afatit të përcaktuar në pikën 2.3.1.

Duke qënë se paraqitja e dokumentacionit të mësipërm, nuk sjell diskriminim dhe/ ose kosto shtesë për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, por i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e përvojës së duhur të tyre, duke mundësuar zhvillimin normal dhe në kohë të procedurës së prokurimit, pasi nuk ka nevojë që A.K., të kërkojë informacione shtesë gjatë vlerësimit të ofertave (në rast mungese të informacionit të sipërcituar), njësia e prokurimit gjykon se kërkimi i dokumentacionit përcaktuar në kushtin e mësipërm është i nevojshëm për vërtetimin e kryerjes së punëve të ngjashme.

Kriteret e mëposhtme teknike nga pika 4.1 dhe ne fund janë propozuar dhe vendosur nga specialisti i fushës, pjesë e njësishë së prokurimit, sipas përcaktimit të nenit 74, dhe 78 të VKM nr. nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik si dhe njoftimit nr. 4916/2 prot, datë 14.07.2022, pika 1, të Agjencisë së Prokurimit Publik “**Mbi organizmin e Procedurave të Prokurimit Publik**”

4.1 Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.

Operatori Ekonomik duhet te disponoje Liçencë të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

- *N.P-1 (Punime germimi e toke)* Niveli A
- *NP- 4 (Rrugë autostrada, mbikalime, hekurudha, linja tramvaj, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale)* Niveli A
- *N.P-7 (Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje)* Niveli D
- *N.P. 9 (Punime mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime.)* Niveli B
- *N.P-12 (Punime te inxhinjerise se mjedisit)* Niveli A

Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

- *N.S.-8 (Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri)* Niveli A
- *N.S-18 (Punime topogjeodezike)* Niveli A

Operatorët ekonomikë duhet të kenë liçencat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë ata duhet të paraqesin liçencën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat për dhënien e

licencave profesionale për zbatimin, klasifikimin dhe disiplinimin e personave juridikë që ushtrojnë veprimtari ndërtimore".

Operatorët e huaj duhet të barazvlerësojnë (ekuivalentojnë) licencat profesionale që ata kanë lëshuar nga vendi i origjinës, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrinë kompetente) në Republikën e Shqipërisë. (Rregullore për kriteret dhe procedurat për lëshimin e licencave profesionale për zbatimin, klasifikimin dhe disiplinimin e personave juridikë që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, miratuar nga VKM, Nr. 42, datë 16.01.2008).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", Nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si dhe Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi". Gjithashtu, të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, Ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, Neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane" si dhe VENDIM Nr. 448, datë 31.7.2025 PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ZBATIMIT TË PUNIMEVE TË NDËRTIMIT DHE TË RREGULLAVE TË KANTIERIT , neni 6 që përcakton kushtet dhe kriteret për subjektet zbatuese si me poshte : 1. Çdo subjekt juridik i licencuar ka të drejtë të ushtrojë veprimtari zbatimi, vetëm për kategoritë e punimeve, që ka përcaktuar në licence .

NP-1 A Punime gjurmimi në tokë

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008, punime gjurmimi në tokë konsiderohen gjurmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjurmohet ose sistemohet vegetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

Vendosja e kësaj pike license si kriter lidhet me zbatimin e punimeve të parashikuara të realizohen nëpërmjet kësaj procedure. Dokumentacioni teknik i hartuar nga projektuesi parashikon punime gjurmimi, sistemimi të dherave dhe ndryshime të volumit të tokës, si rezultat i **Ndërtim i Veprës së Marrjes dhe Zgjatim i Kanalit të Darsisë Njesia Adm- Gjocaj**. Të tilla punime përfshihen në zërat e punimeve të gjurmimit të dheut.

Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

N.P - 4 A Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar punime që përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tramvaji, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrore dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të parandëruar, parafabrikat ose të prodhuar në objekt. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi "goma", "hekur", "zona", kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore

Këto punime janë parashikuar në preventiv. Për zbatimin e punimeve të tilla është e nevojshme që të angazhohen subjekte të specializuara, të cilët zotërojnë licensën N.P – 4. Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit

N.P - 7 D Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar punime të tilla konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin "e shërbimit hidrik kompleks" dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta, si edhe në të gjitha impiantet mekanike të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe

asistencës për një funksionim normal. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, ujësjellësit, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura

Vendosja si kriter teknik i kësaj license lidhet ngushtë me tipologjinë e ndërhyrjeve që parashikohen për realizimin e këtij projekti, sic janë Punimet për Pellgun ujembledhes, kanalin vadites etj

Per sa me siper ne total vlerat për realizimin dhe kompletimin me strukturat e nevojshme që lidhen me objektin, punime plotësuese i përcaktojnë të tilla punime në kategorinë D sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008, të ndryshuar.

N.P - 9 B Punime mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime

Sipas VKM nr.759 të datës 12.11.2014 (Ndryshuar me VKM nr.943, datë 28.12.2016) më sipër cituar punime të tilla *konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta ose në rrjet, si do që të jenë realizuar, të nevojshëm për sistemimin e rrjedhjes së ujërave natyrale ose artificiale si edhe për mbrojtjen e territorit nga këto ujëra, të kompletuara me punimet lidhëse të nevojshme. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar kanale lundruese, grykëderdhjet e lumenjve, konsolidimin e strukturave të anëve të lumenjve dhe përrenjve, argjinatura të llojeve të ndryshme, sistemimin dhe vendosjen e regjimit hidraulik të ujërave sipërfaqësore të veprave të diafragmave të argjinaturave dhe qëndrueshmërisë së shpateve.*

Vendosja si kriter teknik i kësaj license lidhet ngushtë me tipologjinë e ndërhyrjeve që parashikohen për realizimin e këtij projekti, sic janë : Punime për vepren e marrjes,ndertim argjinature mbrojttese te kanalit vadites etj. Per sa me siper ne total vlerat për realizimin dhe kompletimin me strukturat e nevojshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje i përcaktojnë të tilla punime në kategorinë B sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008, të ndryshuar.

N.P - 12 A Punime të inxhinierisë mjedisore

Si punime të tilla, në VKM nr.42 të datës 16.01.2008 *konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik.*

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurorë, dhe të baseneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrave hidrogeologjik nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe rripullëzimeve të punimeve të sistemimit bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karriera dhe mbetjeve inerte.

Ndërhyrja objekt kontrate parashikon ndërhyrje në Rehabilitimin e siperfaqes mjedisore te demtuara. Ndërhyrje të tilla përfshihen në veprimtaritë me ndikim në mjedis. Efektet kryesore në mjedis nga punimet për rehabilitimin e rruges, konsistojnë në vija të përgjithshme si më poshtë: a) emetimet në ajër dhe zhurmat, b) shkarkimet në ujë, ndikimi në tokë, c) ndikimi në florë/faunë, ç) mbetjet e prodhuara d) ndikime social-ekonomike, dh) ndikim në cilësinë e jetës në komunitetin përreth e) ndikim në rritjen e trafikut rrugor, ë) ndikim në peizazhin e zones, h) ndikim në ndryshimet klimatike etj.

Mbështetur në legjislacionin në fuqi, në fushën mjedisore, i cili i përfshin të tilla aktivitete në aktivitetet me ndikim në mjedis Autoriteti Kontraktor ka realizuar Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Raportin Teknik të VNM, si dhe ka marrë Vendimin për VNM Paraprake pranë Institucionit kompetent. Ndikimet në territor nga zbatimi i këtij projekti dhe masat për zbutjen e efekteve shtjellohen në Raportin e VNM.

Masat me efekt financiar për zbutjen e efekteve negative dhe riaftësimin e territorit janë përfshirë në preventivin e punimeve. Në preventiv parashikohen zëra të tillë si: Mbjellje Fidane Peme dekorative, Prerje e sistemim pemesh, transport materiale ndërtimi, dheu dhe depozitim i mbetjeve në landfill. Këto masa janë të nevojshme për procesin e riaftësimit natyror dhe botanik të territorit të përdorur për ndërtim me mbetje të mëdha inerte. Për realizimin e punimeve të parashikuara në preventiv dhe specifikime teknike për riaftësimin e territorit të parcelës ndërtimore është e nevojshme që OE të disponojë licensën përkatëse. Kategoria A i referohet vlerës totale të punimeve për riaftësimin e territorit dhe zbutjen e efekteve negative në preventivin e projektit të zbatimit. Kriteri në fjalë, është një kërkesë e domosdoshme në përputhje të plotë me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike dhe që mund të plotësohet nga çdo operator ekonomik, cili ushtron veprimtarinë e vetë në fushën e ndërtimit dhe ka kapacitetet teknike të nevojshme për zbatimin e kontrates. Kjo është një kërkesë minimale në

përpjestim me vlerën dhe rëndësinë e kontratës që prokurohet, në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi, dhe që ka për qëllim të provojë se operatori ekonomik ka kapacitetet teknike për zbatimin me sukses të kontratës objekt prokurimi.

N.S- 8 A Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri

Përfshin prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vepër të strukturave parafabrikate prej betoni të armuar, normal dhe të parandëruar. Prodhimin në kantier dhe montimin në vepër të strukturave prej çeliku ose të fasadave të përbëra nga telajo metalike dhe elemente modulare prej xhami ose materiali tjetër. Prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vend të strukturave të përbëra nga elementë të drejtë të trajtuar përpara. Vendosja e këtij kriteri u referohet punimeve të parashikuara në projektet teknikë, relacionet teknikë, specifikimet, preventivin dhe grafikun e punimeve për zbatimin e veprës. Këto punime parqiten të detajuara në projektin arkitekturor dhe specifikimet e punimeve ndërtimore. Punimet e parashikuara në këtë dokumentacion teknik përfshijnë Konstruksione metalike te perbera (porta) etj. Vëllimi dhe vlerat e punimeve të tilla janë të konsiderueshme. Për zbatimin e punimeve të tilla, VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar, përcakton se duhet të disponohet licenca NS-8.

Nga sa më sipër, duke marrë në analizë të gjithë dokumentacionin teknik, specifikën e punimeve dhe vlerat e të gjithë punimeve të tilla në preventivin total të kësaj ndërhyrjeje, u vendos si kriter teknik profesional licenca NS-8 A, e cila është e domosdoshme për vlerën, rëndësinë dhe kompleksitetin e punimeve të tilla.

N.S - 18 A Punime topogjeodezike.

Punime të tilla përfshijnë zbatimin e rievimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, *punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.*

Sikurse shtjellohet në specifikimet teknike të punimeve ndërtimore, mbështetur në dokumentacionin topografik të hartuar nga projektuesi dhe dokumentacionin e pronësisë së objektit, Kontraktori duhet të kryejë transferimin e pikave referenciale dhe gjurmës së objektit në terren, si dhe çdo shërbim tjetër topografik, të nevojshëm për zbatimin e saktë të projektit.

Shtesa tre kateshe e objektit te parashikuar të ndërtohet ka një planimetri sheshi dhe një kufi prone me formë të thyer, planimetritë e tij zhvillohen në disa nivele dhe disnivele, volumetria është komplekse dhe zbatimi jo i saktë i të projektit në të gjitha nivelet mund të çojë në dëme kolosale dhe pamundësi teknike për realizimin e duhur të këtij konstruksioni. Kategoria A i referohet vlerës totale të punimeve për riaftësimin e territorit dhe zbutjen e efekteve negative në preventivin e projektit të zbatimit. Kriteri në fjalë, është një kërkesë e domosdoshme në përputhje të plotë me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike dhe që mund të plotësohet nga çdo operator ekonomik, cili ushtron veprimtarinë e vetë në fushën e ndërtimit dhe ka kapacitetet teknike të nevojshme për zbatimin e kontrates. Kjo është një kërkesë minimale në përpjestim me vlerën dhe rëndësinë e kontratës që prokurohet, në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi, dhe që ka për qëllim të provojë se operatori ekonomik ka kapacitetet teknike për zbatimin me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategori a e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimi t i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
N.P-1 A	Punime gërmimi në tokë	Gërmim dheu me ekskavator zingjir 1.0 m ³ , ne kanale gjerësi > 2 m, prani uji ~ 2m, kategoria IV, me shk ne toke (vepra) Gërmim shkëmbi mesatar me çekiç me ekskavator me zinxhir 3 Transport dheu me auto deri 5 km	0-20 mln leke	14.988.198,58

N.P-4 A	Rrugë autostrada, mbikalime, hekurudha, linja tramvaj, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale	Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri	0-20 mln leke	185.590,02
N.P-7 D	Ujësjiellës, gazsjiellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje	Nenshtrese zhavori per kanalin t=20CM Blloqe beton per Themelin C-16/20 Struktura te holla monolite betoni C 20/25 per kanalin t=20cm Struktura te holla monolite betoni C 25/30 (Pellgu ujembledhes) F.V. Hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm (Pellgu ujembledhes) F.V. Hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm (kanali) Hekur per kapje blloqe betoni	101-200 mln leke	149.201.226,42
N.P-9 B	Punime mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime	Struktura monolite betoni C 25/30 (Dhemb i themelit te vepres marrjes) Struktura monolite betoni C 25/30 (Themeli i vepres marrjes) Struktura monolite betoni C 25/30 (Muret e vepres marrjes) Struktura te holla monolite betoni C 25/30 F.V. Hekur betoni i zakonshem Ø > 12mm (vepra marrjes) F.V. Hekur betoni i zakonshem Ø > 12mm (shpatullat) Mbushje me gure kave D>1.5m Mbushje me zhavorr lumi (Kanali) Mbushje me gure kave t=2ton/m3 ne blloqe, D=0.8-1.2 Gabiona me rrjete teli te zinguar e gure kave 1x1x1 m Gabiona me rrjete teli te zinguar, gure kave 1x1x2 m	21-50 mln leke	37.001.879,85
N.P-12 A	Punime të inxhinierisë së mjedisit	Punime per mbrojtjen e mjedisit vendgrumbullimin e materialit te dale nga germimi, uljen e nivelit te pluhurave, zhurmave. Referuar dhe ne termat e references Prerje e sistemim pemesh ø 21 ~ 40 cm F.V. Fidane Peme dekorative	0-20 mln leke	801.356,30 +
N.S- 8 A	Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri	F.V. Konstrukione metalike te perbera (porta)	0-20 mln leke	157.272,18
N.S-18. A	Punime topogjeodezike	RILEVIM TOPOGRAFIK, Ne referim termat e references	0-20 mln leke	

4.2 Operatori Ekonomik duhet te jete i licensuar nga QKB me

a. Licencë kategoria III.2.B për “Grumbullim, transportim, ruajtje/magazinin, rikuperim te mbetjeve te llojeve te ndryshme”

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, licencat e mesiperme duhet te disponohen nga nga anetari qe do te kryejë sherbimet perkatese).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM. nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Vendim Nr. 538 date 26.05.2009 ”Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet Qendres Kombetare te Licencimit (QKL) dhe disa rregullime te tjera nenligjore te perbashketa”. si dhe ne permbushje te detyrimeve ligjore qe percakton Ligji 10431 date 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” (te ndryshuar).

Ky kriter synon mbrojtjen e mjedisit dhe shendetit nga ndotja dhe demtimi prej mbetjeve te ngurta, nepermjet administrimit mjedisor te tyre ne cdo faze, perfshi krijimin, grumbullimin, ndarjen, ruajtjen, transportin, riciklimin, perpunimin, magazinimin, asgjесimin, te cilat cojne ne pakesimin e mbetjeve dhe zvogelimin e ndikimeve te tyre te rrezikshme e te demshme. Duke qene se ne preventivin e punimeve jane pasqyruar punime prishje, germimi eshte gjykuar qe subjekti duhet te kete lejen e posacme per veprimtari te tilla si Stacionim transferimi per mbetjet nga prishjet dhe ndertimet, per mbetjet e ngurta urbane dhe magazinim i perkoshem i tyre.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat/lejet profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e proceseve te punes te parashikuara ne preventivin objekt kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente

4.3 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, te perfshire ne licensen e shoqerise, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajit e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, konkretisht:

- Inxhinier Ndertimi 1(një)
- Inxhinier Ndertimi profili Strukturist 1(një)
- Inxhinier Mjedisi 1(një)
- Inxhinier Mekanik 1(një)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (nje)
- Inxhinier Gjeodet 1 (një)
- Agronom 1(një)

Për plotësimin e kësaj kërkesë operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë personelin e mësipërm në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8, ndërsa përpara lidhjes/nënshkrimit të kontratës operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë për personelin inxhinier të sipërcituar dokumentacion e lart përmendur

Shenim : Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë per inxhinieret e mesiperm, emer/mbiemer, atesia, numrin personal te ID , numrin dhe titullin e kualifikimit per diplomën përkatëse, si dhe institucionin qe ka leshuar kete dokument.

Argumentim: Autoriteti Kontraktor këto kriteret i ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6.

Keto kriteret i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për tu bindur se OE zotëron kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, aftësitë organizative, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Këtu nga AK janë përcaktuar kriteret e nevojshme për personelin e kualifikuar sipas niveleve të ndryshme të kualifikimit dhe profileve të nevojshme mbështetur në tipologjinë e punimeve, si dhe kërkesat për fuqi punëtoresh referuar përmasave dhe natyrës së kontratës, objekt prokurimi.

Në kërkesat për personelin e kualifikuar nga AK janë kërkuar disa kategori personeli, të domosdoshëm për të kryer të gjitha shërbimet e nevojshme dhe mbulimin e të gjitha hallkave/etapave të zbatimit të projektit, sipas nivelit të kompetencave profesionale deri në realizimin e plotë të veprës.

Në kërkesat për personelin e kualifikuar janë kërkuar ekspertët inxhinierë të licensuar, sipas profileve të domosdoshme për të mbuluar të gjitha punimet e parashikuara në projekt – zbatimin e parashikuar të relizohet nëpërmjet kësaj kontrate, te cilet duhet të jenë të përfshirë në licensën e shoqërisë.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. **Drejtuesi teknik është përgjegjës** për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

Referuar natyrës dhe përmasave të kontratës objekt prokurimi, me qëllim ndërtimin e investimit tejet të rëndësishëm sipas projektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, dhe **vërtetimin e aftësisë organizative, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën**, njësia e prokurimit referuar zërave të punimeve që do të kryhen objekt kontrate, **vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë stafin e drejtuesve teknik (inxhinierët) me kualifikimet e kërkuara**. Kërkesa specifike për inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të preventivit të punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik), ku më hollësisht parashikohet:

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë , kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

-Projekt, objekt i kësaj kontrate parashikon punime të përgjithshme ndërtimore, të tilla si punimet e gërmimit, punimet e kanaleve, punime betonimi etj. Punimet e ndërtimit duhet të përmbushin kushtet teknike të zbatimit. Respektimi i kërkesave për qëndrueshmëri strukturore dhe qëndrueshmëri, përdorimi i materialeve që nuk janë të dëmshëm për jetën dhe shëndetin e përdoruesve të ambienteve dhe saktësia në realizimin e të gjithë elementëve konstruktivë sjellin domosdoshmërinë që çdo element dhe hallkë e zbatimit të këtyre punimeve të ndiqet dhe udhëhiqet nga ekspertë të licensuar të fushës.

Zbatimi i punimeve të përgjithshme ndërtimore duhet të realizohet me materialet dhe teknologjitë e parashikuara në projektin e zbatimit, metodologjia e ndëkur e zbatimit të këtyre punimeve duhet të përputhet me specifikimet teknike dhe standardet dhe kriteret e zbatimit nga ekspert inxhinier ndërtimi. Ndjekja e të gjithë procesit ndërtimor që në fazën e pare, punimet e ngritjes së kantierit, do të ishte e nevojshme që të angazhohesh nje inxhinier ndërtimi. Në kriteret e veçanta të kualifikimit është kërkuar angazhimi i të paktën nje eksperti inxhinier ndërtimi i licesnuar, i cili të jete te përfshirë në licensën e shoqërisë.

Inxhinieri i Ndërtimit është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar preventivit si dhe per sigurimin teknik në proceset e punes. Ky inxhinier ka per qëllim menaxhimin e zbatimit të punimeve ndërtimore, analizimin e projektit pasi kemi të bëjmë me punime ndërtimi apo rikonstruksioni, ndjekjen e ecurisë së punimeve në kantier;

-Ndjekja e procesit ndërtimor per realizimin e strukturave mbajtëse, punimet e përforcimit strukturor në preventvin respektiv në këte objekt do të ishte e nevojshme që të angazhohesh nje inxhinier ndërtimi. Në kriteret e veçanta të kualifikimit është kërkuar angazhimi i të paktën nje eksperti **inxhinier ndërtimi i licesnuar ne profilin strukture**, i cili të jete te përfshirë në licensën e shoqërisë.

- Gjatë zbatimit të punimeve të nëntokës është e domosdoshme që të mbahen në konsideratë faktorët gjeologjikë, integrimi i projektit dhe ambientin përreth, kërkesat konstruktive dhe teknike dhe rrjetet nëntokësore. Për ndjekjen e punimeve të tilla dhe shmangien e ngjarjeve të rrezikshme, apo marrjen e masave për zgjidhjen e

problematikës konstruktive nga një ngjarje eventuale është e domosdoshme që pjesë e stafit inxhinierik të OE të jetë edhe të paktën një inxhinier hidrogeolog. Ai duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë si drejtues teknik, duke qenë se drejtuesit ligjorë dhe teknikë të OE janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës.

Punimet për riaftësimin e territorit, si rezultat i dëmeve në mjedis që do të shkaktohen si rezultat i punimeve ndërtimore për zhvillimin e territorit nëpërmjet Ndërtimit të Veprës së Marrjes dhe Zgjatim të Kanalit të Darsisë duhet të drejtohet nga të paktën një inxhinier i licensuar në fushën përkatëse, **inxhinier mjedisi**. Perpos edhe në raportin e Vleresimit të Ndikimit në Mjedis, jepet informacioni i duhur për aktivitetin që është menduar të kryhet në përputhje me kërkesat mjedisore, si dhe për zhvillimin e aktivitetit që do të jetë në përputhje me kriteret për mbrojtjen e mjedisit pra për zbatimin dhe zhvillimin e aktivitetit nevojitet eksperiencia profesionale e Inxhinierit të Mjedisit. Duke qenë se punimet do të kryhen në mjedis të pasur, lind e domosdoshme disponimi i këtij inxhinieri, pasi mbrojtja e mjedisit gjatë kryerjes së punimeve ka një rëndësi shumë të veçantë.

Ne lidhje me kërkesën e Drejtuesit Teknik inxhinier Mjedisi, Njesia ka marre ne konsiderate dhe thekson se referuar raportit teknik dhe Specifikimeve teknike të projektit objekt prokurimi dhe kompleksitetit të kontratës, Zbatuesi i Punimeve është ngarkuar me detyrime të përgjithshme në kujdesin për mjedisin. Metodat e punës që duhet të aplikohen nga zbatuesi duhet të synojnë në minimizimin ose nëse është e mundur në ndalimin e cenimeve ndaj mjedisit. Gjithashtu kërkohej që të ndërmerren me rigorozitet masa mbrojtëse sa herë që të jete e nevojshme për të minimizuar ose për të ndaluar efektin negativ në mjedis.

Ne lidhje me kërkesën e Drejtuesit Teknik inxhinier Gjeodet, Njesia ka marre ne konsiderate dhe thekson se referuar raportit teknik dhe specifikimeve teknike të projektit objekt prokurimi dhe kompleksitetit të kontratës, i gjithë piketimi do të kryhet nga Sipermarresi.

Inxhinier Gjeodet / Topograf është përgjegjës për kontrollin e punimeve të germimeve, pasi do të kryejë azhurnimin topografik dhe piketimin e objektit si dhe do të ndjekë punimet e zbatimit sipas kuotave të projektit. Gjithashtu pas përfundimit të punimeve do të bëjë edhe azhurnimin faktit (as built); Ky inxhinier është i nevojshëm për dhënien në terren të kuotave të nevojshme mbi dhe nën tokësore gjatë zbatimit të punimeve të objektit deri në përfundimin e plotë të tij në përputhje me kuotat e përcaktuara në projektin e zbatimit të objektit.

-Objekti i parashikuar të rehabilitohet në teresinë e tij është punime hidroteknike, pasi kemi të bëjmë me Ndërtim të Veprës së Marrjes dhe Zgjatim të Kanalit të Darsisë. Për realizimin e këtij projektit hidroteknik, zbatuesi duhet të mbështetet në projektin, relacionin, specifikimet teknike, preventivin dhe grafikun e punimeve hidroteknike. Punimet duhet të realizohen në përputhje me zgjidhjet teknike dhe specifikimet e projektuesit. Për drejtimin teknik të këtyre punimeve është e nevojshme që të angazhohen minimalisht dy inxhinierë hidroteknike të përfshirë në licensën e shoqërisë.

Inxhinieri Hidroteknik është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar zerave hidroteknike, etj.

-Projekti që do të zbatohet nëpërmjet kësaj procedure prokurimi përmban si komponent të tij edhe Konstruksione metalike të perbera (porta). Ky zë kërkon zgjidhjet grafike sipas relacionit teknik, specifikimeve teknike dhe preventivin e realizimit të punimeve. Realizimi i këtij zëri për të gjithë vëllimet e objektit është shumë i rëndësishëm për sigurimin e Veprës së Marrjes dhe Zgjatim të Kanalit të Darsisë. Sigurimi i tij duke veçuar tipologjitë e veçanta funksionale është domosdoshmëri. Nisur nga vëllimi i punimeve, sjell nevojën që minimalisht të angazhohen në zbatimin e punimeve një ekspert **inxhinier mekanikë i licensuar** i përfshirë në licensën e shoqërisë.

Duke qenë se objekti i kontratës ka për qëllim Ndërtim të Veprës së Marrjes dhe Zgjatim të Kanalit të Darsisë që shërben drejtpërdrejt për ujitjen e tokës bujqësore, mbjelljen e pemeve dekorative si dhe kujdesjen ndaj tyre për të gjithë periudhën e garancisë së punimeve, realizimi i saj kërkon njohuri jo vetëm në fushën e ndërtimit hidroteknik, por edhe në administrimin agronomik të ujitjes, kërkesat hidrike të kulturave bujqësore, funksionimin e rrjetit të shpërndarjes së ujit dhe efektivitetin e skemës së ujitjes. Për këtë arsye, prania e një **inxhinieri agronom** në stafin teknik është e domosdoshme për të garantuar që investimi të përmbushë funksionin për të cilin financohet. Kjo kërkesë lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe është proporcionale me qëllimin e saj, duke garantuar funksionalitetin agronomik të skemës së ujitjes."

Lidhur me kërkesën që Drejtuesit Teknik të punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKB apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin, stafin mbështetës si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

4.4 Kandidati ofertues duhet të përcaktoje me anë të një deklarate (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve Inxhinier Ndërtimi në objekt të përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtem si dhe të ketë eksperiencë pune minimum.

- i. Libreze pune (perkatëse)
- ii. CV perkatëse
- iii. Kontrate pune e vlefshme (përkatëse)
- iv. Diplomë

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarime të reme do të veprohet në përputhje me nenin 13, pika 3, gërma a, të Ligjit 9643, dt 20.11.2006 i ndryshuar “Për Prokurimet Publike”

Argumentimi: Së pari, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Vendosja e këtij kriteri mbështetet në VENDIM Nr. 448, datë 31.7.2025 PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ZBATIMIT TË PUNIMEVE TË NDËRTIMIT DHE TË RREGULLAVE TË KANTIERIT VKM Udhëzimin nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, neni 8 që përcakton se Drejtuesi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i zbatuesit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Për vepra me vlerë të plotë, të preventivuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të

drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dipsozitive ligjore në fuqi.

4.5 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/certifikuar si:

- **1 (një)** punonjes i pajisur me çertifikate **“Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”** e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Per kete duhet te paraqitet certifikata e trajnimit si Ekspert per dhenien e ndihmes se pare dhe nderhyrjes ndaj emergjencave” e dhene nga nje organizem i licensuar, shqiptar ose i huaj, kontrata e punes si dhe të rezultojë në listpagesat e shoqërisë për te pakten tre muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit. *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga te gjithë anetaret e BOE.*
- **1 (një)** punonjës të disponojë çertifikatë si **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë** në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Per kete duhet te paraqitet certifikata e trajnimit per “Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit per pune”, e dhene nga nje organizem i akredituar, shqiptar ose i huaj, kontrata e punes si dhe të rezultojë në listpagesat e shoqërisë për te pakten tre muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit. *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga te gjithë anetaret e BOE.*
- **1(nje)** punonjes, duhet te jene te pajisur me certifikaten te Trajnimit për **“Pergjegjes per sigurimin dhe kontrollin e cilesise sipas ISO 9001:2015”**, e dhëne nga nje organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj.(Për pergjegjesin e kontrollit te cilesise duhet te paraqitet Certifikata perkatese si dhe Kontrata e punes e vlefshme si dhe të rezultojë në listpagesat e shoqërisë për te pakten tre muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit. *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga te gjithë anetaret e BOE.*
- **1(nje)** punonjes i certifikuar si **Koordinator Saldimi** sipas standardeve ndërkombëtare EN ISO 14731 ose ekuivalente, lëshuar nga shoqëri të licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë.
-

Argumentimi 2.3.5: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” Neni 7 Sherbimet e mbrojtjes dhe te parandalimit ... 1. Punedhenesi ngarkon nje ose disa punemarres, qe te merren me ceshtjet e mbrojtjes, te sigurise e shendetit ne pune dhe te parandalimit te rreziqeve profesionale ne ndermarrje /institucion, dhe V.K.M nr.312, date 05.05.2010 “Per miratimin e rregullores per sigurine ne kantier”. Autoriteti Kontraktor ka qellim realizimin e kontrates objekt prokurimi sipas kushteve te percaktuara ne DST, duke respektuar cdo rregull lidhur me kantierin e ndertimit si dhe me sigurine e punonjesve gjate ushtrimit te veprimtarise se punes. Eshte e rendesishme qe punimet te realizohen brenda nje kantieri te sigurt duke mbrojtur jeten e punonjesve, por dhe te kalimtareve qe mund te jene perreth vendit te punimeve. Per sa me lart, punonjesi i cili eshte i certifikuar si "Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune", nepermjet dijes dhe eksperiences te fituar ne kete fushe, duhet te shmange apo parandaloje cdo rrezik qe mund te shfaqet gjate veprimtarise se shoqerise dhe qe

mund të cenoje shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

Kërkesa për “Ekspert për Ndihmën e parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave”, është e lidhur me natyrën e kontratës dhe specifikat e saj, të cilat kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. **Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit.** Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

Kërkesa për disponimin e një Përgjegjësi për Sigurimin dhe Kontrollin e Cilësisë, i cili administron dhe monitoron zbatimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë sipas standardit ISO 9001:2015, është e bazuar në legjislacionin e prokurimit publik dhe në nevojën për garantimin e cilësisë së realizimit të kontratës. Në kontratat e punimeve (veçanërisht ndërtimore, infrastrukturore, restaurimi, ujësjellës, mbrojtje lumore, sisteme teknologjike etj.), cilësia nuk garantohet vetëm nga drejtuesi teknik, por edhe nga një sistem i organizuar i kontrollit të cilësisë.

Duke qenë se objekti i kontratës kërkon kontroll sistematik të cilësisë gjatë gjithë fazës së zbatimit, kërkesa për një **Përgjegjës për Sigurimin dhe Kontrollin e Cilësisë sipas ISO 9001:2015** është e lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës, e bazuar në Ligjin nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" dhe aktet nënligjore në fuqi, proporcionale me natyrën dhe kompleksitetin e kontratës si dhe është e nevojshme për garantimin e cilësisë, përmbushjen e specifikimeve teknike dhe mbrojtjen e interesit publik.

Referuar **Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik"**, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore në fuqi për zbatimin e tij, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kërkojë personel kyç që provon kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit ekonomik, kur ky personel është i nevojshëm për realizimin korrekt të kontratës. Në këtë kuadër, kërkesa për një **Koordinator Saldimi** është e justifikuar pasi objekti i kontratës përfshin procese saldimi që ndikojnë drejtpërdrejt në sigurinë, rezistencën dhe funksionalitetin e veprës.

-Duke qenë se objekti i kontratës përfshin procese saldimi që ndikojnë drejtpërdrejt në sigurinë, funksionalitetin dhe jetëgjatësinë e veprës, kërkesa për një **Koordinator Saldimi**, me kompetenca të përcaktuara sipas **ISO 14731** dhe në përputhje me kërkesat e **ISO 3834**, është e lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës. Sipas ISO 14731, organizata që realizojnë punime saldimi duhet të caktojë persona kompetentë për koordinimin e aktiviteteve të saldimit, në mënyrë që të garantohet përputhshmëria me kërkesat teknike dhe cilësore.

Defektet në saldim mund të shkaktojnë: ulje të rezistencës strukturore; rrjedhje në tubacione dhe rezervuarë; dështim të elementeve mbajtëse; rrezik për jetën dhe shëndetin; kosto të konsiderueshme riparimi; vonesa në realizimin e kontratës. Prandaj, prania e një Koordinatori të Saldimit kontribuon në parandalimin e këtyre rreziqeve dhe garanton përmbushjen e kërkesave teknike të projektit.

Për këtë arsye, koordinimi teknik i proceseve të saldimit duhet të kryhet nga një person me kompetencë të specializuar.

Në këto raste, kërkesa nuk kufizon konkurrencën, por siguron që operatorët ekonomikë të disponojnë kapacitetin profesional të nevojshëm për realizimin e sigurt dhe cilësor të punimeve.

4.6 Operatori Ekonomik duhet të ketë fuqi minimale punetore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, me një numer prej mesatarisht **165 (njqind e gjashtedhejte e pese)** personave, mesatarisht për të paktën tre muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për të paktën tre muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

- Listepagesat e deklaruar ne organet tatimore bazuar në vkm nr 514 date 20.09.2017 “Per miratimin e listes kombetare te profesioneve” për te pakten tre muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuese ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gërmën dh) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK

Argumentimi: Në përcaktimin e numrit te punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale te lejuar qe duhen per te permbushur kontratesn. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje per 3 (tre) muajt e fundit, te deklaruar nga data e hapjes se ofertave , tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrate tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. *po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosija e kriterit për një punësim te paktën 165 persona duke përfshire dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet.*

Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithëka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Analizat teknike jane bazuar ne VKM Nr. 216, datë 13.4.2023 “ Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” .Bazuar ne kater elementet e struktures se kosos(material, puntori, makineri, transport).

Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

Kete perlllogaritje si nevoje e transparencies ndaj ofertuesve po e paraqesim te detajuar si me poshte:

NR.	KODI	EMËRTIMI I PUNIMEVE.	NJËSIA	SASIA	ore pune /njesi	Total ore pune
		1.VEPRA E MARRJES				
1	3.124/1a	Germim shkambi mesatar me çekiç me ekskavator me zinxhir 3	m3	2613		-
2	3.25/a	Germim dheu me ekskavator zingjir 1.0 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, prani uji ~ 2m, kategoria IV, me shk ne toke (vepra)	m3	374	4.9	1,832.60

3	3.211	Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri	m2	187	0.28	52.36
4	3.245	Struktura monolite betoni C 25/30 (Dhemb i themelit te vepres marrjes)	m3	60	12.8	768.00
5	3.245	Struktura monolite betoni C 25/30 (Themeli i vepres marrjes)	m3	137.3	12.8	1,757.44
6	3.245	Struktura monolite betoni C 25/30 (Muret e vepres marrjes)	m3	60.75	12.8	777.60
7	3.245/1	Struktura te holla monolite betoni C 25/30	m3	43.45	12.8	556.16
8	3.288	F.V. Hekur betoni i zakonshem Ø > 12mm (vepra marrjes)	ton	6.44	42	270.48
9	3.288	F.V. Hekur betoni i zakonshem Ø > 12mm (shpatullat)	ton	3.85	42	161.70
10	3.352	Mbushje me gure kave D>1.5m	m3	195.6	3.4	665.04
11	3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5.0 km	m3	2987		-
2.PUNIME GERMIMI DHE SISTEMIMI						
1	3.109/b	Germim dheu me ekskavator zingjir 1.0 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, prani uji ~ 2m, kategoria IV, me shk ne toke	m3	8940.15		-
2	3.109/b	Germim dheu me ekskavator zingjir 1.0 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, prani uji ~ 2m, kategoria IV, me shk ne toke (Hapje trase)	m3	6088		-
3	3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5.0 km	m3	15028.14		-
4	3.4	Prerje e sistemim pemesh ø 21 ~ 40cm	copë	575	1.2	690.00
5	3.961	F.V. Fidane Peme dekorative	copë	44	1	44.00
3.PUNIME MBUSHJE						
1	3.396/1	Mbushje me zhavorr lumi (Kanali)	m3	9641.54	0.04	385.66
2	3.352	Mbushje me gure kave t=2ton/m3 ne blloqe,D=0.8-1.2	m3	1650.0	3.4	5,610.00
4.PUNIME BETONI PER ARGJINATUREN DHE KANALIN						
1	2.258	Nenshtrese zhavori per kanalin t=20CM	m3	3196.8	2.9	9,270.72
2	3.243/1	Blloqe beton per Themelin C-16/20	m3	4113.2	12.8	52,648.96
3	3.244/1	Struktura te holla monolite betoni C 20/25 per kanalin t=20cm	m3	3196.8	12.8	40,919.04
4	3.245/1	Struktura te holla monolite betoni C 25/30 (Pellgu ujembledhes)	m3	209	12.8	2,675.20
5	2.166	F.V. Hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm (Pellgu ujembledhes)	ton	3.87	60	232.20

6	2.166	F.V. Hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm (kanali)	ton	104	60	6,240.00
7	3.288	Hekur per kapje blloqe betoni	ton	3	42	126.00
8	3.331	Gabiona me rrjete teli te zinguar e gure kave 1x1x1 m	m3	20.00	5.6	112.00
9	3.333	Gabiona me rrjete teli te zinguar, gure kave 1x1x2 m	m3	40.00	5.1	204.00
10	2.181	F.V. Konstruksione metalike te perbera (porta)	ton	1.00	48	48.00
Sipas Manualeve teknike të çmimeve VKM Nr. 216, datë 13.4.2023				Ore pune total		126,047.16
				Dite pune 8 orarshe		15,755.90
Afatit punimeve 5 muaj, Sipas Kodit te Punes 22 x 5				Dite pune sipas afatit		110.00
				Fuqia punetore		143.24
				Stafi inxhinierik dhe teknik		12.00
				Manovratore/shofere		10.00
				TOTAL fuqi punetore		165.24

4.7 Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si dhe të përfshirë në listepagesa për periudhën 3 muajt e fundit, me profesionet si mëposhtë:

- Teknik Ndërtimi 2 (dy)
- Teknik topograf 1 (një)
- Betonues 35 (tridhjetë e pese)
- Karpentier 22 (njezet e dy)
- Hekurkthyes 8 (tete)
- Gurepunues 8 (tete)
- Specialist konstruksione metalike 1 (nje)
- Mekanik 1 (nje)
- 2 (dy) **Saldator për punime në prani uji sipas UNI EN ISO 15618-1**, certifikata e vlefshme dhe e lëshuar nga institucione te akredituara te njohura nga Republika e Shqipërisë. UNI EN ISO 15618-1:2016 është një standard teknik europian / ndërkombëtar për kualifikimin dhe certifikimin e saldatorëve prani ujë (underwater welders) që bëjnë saldim në ambient hiperbarik të lagësht (hyperbaric wet welding), kryesisht mbi çelik.
- 3 (tre) **Saldator për punime speciale saldimi sipas EN 9606:1-2017**, certifikata e vlefshme dhe e lëshuar nga institucione te akredituara te njohura nga Republika e Shqipërisë. Saldator për punime speciale saldimi sipas EN ISO 9606-1 do të thotë një saldator i kualifikuar dhe certifikuar sipas standardit EN ISO 9606-1, i cili mbulon testimin e saldatorëve për saldim me shkrirje të çelikut (fusion welding of steels).
- Kopeshtare 5 (pese)

Krahas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës perkatese në DST, për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemër I punonjësit	Profesioni	Institucioni 22onfor/privat lëshues I certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)	NR AMZES
1.					
2.					
etj.					

* Disponimi i stafit/ punonjësve sipas specialitetit të kërkuar, duhet të deklarohet nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës perkatese në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin punonjës, duhet të paraqesë dokumentacionin: Për specialistët e sipercituar sipas profesioneve, duhet të paraqiten, deshmitë/certifikatat ose cdo dokument tjetër që verteton diplomimin/trajnimin/ose kualifikimin e tyre sipas profesionit, si dhe kontratat individuale të punës të vlefshme.

- Kontrata e punës e vlefshme,
- Dëshmi/ certifikatë kualifikimi të lëshuara nga institucione publike/ private akredituara/licensuara për kurset e ofruara, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” për specialistët, ndërsa për teknikët duhet të paraqiten diplomat e shkollës së mesme/ ose te larte,
- Secili specialistë i sipercituar sipas profesioneve, duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt e fundit, nga data e zhvillimit të tenderit.

Argumentim Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, sipas fushave që përfshijnë punimet për zbatimin e projektit.

Këtu përfshihen kërkesat për punonjësit, të cilët janë trajnuar/certifikuar për kryerjen e punimeve të caktuara të zbatimit, pasi kanë kryer me sukses kurse dhe trajnime profesionale për punimet respektive. Zbatimi i punimeve që përfshin projekti duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Nisur nga punimet e parashikuara të zbatimit, në kriteret e veçanta janë kërkuar punëtorët e kualifikuar si vijon:

Teknik ndërtimi është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, në përputhje me projektin dhe preventivin.

-Për zbatimin e punimeve ndërtimore të tilla si punimet e gërmimit, punimet strukturore, punimet e shtresave, etj janë kërkuar 2 (dy) teknikë ndërtimi . Prania e dy teknikeve është e nevojshme për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit, sipas zërave të preventivave të punimeve. Kërkesa për 2 (dy) Teknike Ndërtimi vjen pasi objekti i prokurimit do të jetë i shtrirë në një afat të shkurtër dhe për këtë arsye duhet prania e dy punonjësve të tillë Kjo është një kërkesë shumë minimale, duke marrë parasysh vëllimin e punimeve dhe grafikun e punimeve.

Teknik topograf është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të rehabilitimit të kanalit ujtes, sipas zërave të preventivit të punimeve. duke patur parasysh që do të kryhen piktetimit të objektit etj.

Betonuesi është i nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve të betonimit në objekt, sipas zërave të punimeve ndërtimore, në përputhje me projektin dhe preventivin

Karpentieri është i nevojshëm për përgatitjen e kallëpeve të betonit dhe skelerive sipas zërave të punimeve ndërtimore, në përputhje me projektin dhe preventivin.

Gjthashtu punimet e betonit dhe b/a të parashikuara në projektin konstruktiv, specififikimet teknike, prevetivin dhe grafikun e punimeve lidhen ngushtë me proceset e derdhjes së betonit, pjesë e të cilave është edhe pregatitja e kallëpëve. Për realizimin e punimeve të tilla është e nevojshme që OE të zotërojë minimalisht 57 (pesedhjetë e shtatë) punëtorë të kualifikuar për realizimin e tyre, karpentier dhe specialiste betonues. Sipas preventivit kemi të bëjmë me një volum të madh të punimeve të betonit, janë 7.821 m³. Sipas Listës Shqiptare të Profesionëve, të tillë punëtorë realizojnë punime të tilla si kryerjen e matjeve dhe prerjeve sipas përmasave të përcaktuara në projekt, bëjnë piketimin dhe armaturën anësore të themelit, bëjnë vendosjen e modinave për kolonat dhe muret e betonit sipas projektit, ndërtojnë armaturën, kallëpet e kolonave, mureve, shkallëve, urave apo strukturave të tjera, duke respektuar radhën e punës, me materiale druri, plastike, apo metalike sipas specifikimeve teknike, montojnë skelerinë përforcuese për fazën e betonimit të mureve dhe kolonave, kontrollojnë vertikalishtet e armaturës (peshon) me plumbçe, nxjerrin kuotat e lartësisë së katit sipas projektit (para betonimit), lagin armaturën para betonimit, ndërtojnë skelën për armaturën e trarëve dhe soletës duke ndjekur proceset e tjera të punës, vendosin polisterolin ose tullat në soletë apo në struktura të tjera (për rastin e soletave të lehtësuara), bëjnë disarmimin e kolonave, mureve dhe soletës apo strukturave të tjera duke respektuar afatet e duhura, kryejnë pastrimin dhe sistemimin e armaturës etj. Konkretisht për kryerjen e punimeve për zerat e punimeve të betonit në mbështetje të Manualit të ndërtimit miratuar me Vendim Nr. 216, datë 13.4.2023 *duhen gjithësej 100.102 ore pune ose 12.512 dite pune 8 orarshe. Afati i punimeve është 5 muaj dhe kemi që për realizimin në afat të punimeve për punimet e betonit duhen 114 punonjes. Duke qene se për realizimin e ketyre zerave nuk është domosdoshmeri që të jene të gjithë specialiste betonues dhe karpentier, pasi duhen edhe punetore të thjeshte që do merren me transport materiali tek vendi i punes dhe punime të tjera të kesaj natyre, prandaj është gjykuar që nga 114 punonjes të jene specialiste betonues dhe karpentier 50% e tyre. Pra 57 punonjes për punimet e betonit nga të cilët 35 specialiste betonues dhe 22 specialiste karpentiere*

Kërkesa që OE të ketë të punësuar minimalisht 35 (tridhjetë e pese) betonues dhe 22 (njezet e dy) karpentier, është kërkesë e diktuar nga vëllimi i punimeve dhe grafiku i shkurter i punimeve.

Hekurkthyesi është i nevojshëm për përzgjedhjen, prerjen, kthimin dhe vendosjen e hekurit, sipas zërave të punimeve ndërtimore, në përputhje me projektin dhe preventivin

-Në prevetivin e punimeve është parashikuar punime hekuri dhe betoni. Hekur betoni periodik është parashikuar në sasinë 121.16 ton Për kthimin e hekurit të domosdoshëm për strukturat b/a janë kërkuar minimalisht 8 (tete) hekurkthyes. Konkretisht për kryerjen e punimeve për zerat e punimeve të hekurit në mbështetje të Manualit të ndërtimit miratuar me Vendim Nr. 216, datë 13.4.2023 *duhen gjithësej 7031 ore pune ose 879 dite pune 8 orarshe. Afati i punimeve është 5 muaj dhe kemi që për realizimin në afat të punimeve të kthimit të hekurit duhen 8 specialist hekurkthyes.* Gjthashtu hekurkthyesit nevojiten për realizimin e punimeve të tilla si matjet e duhura të hekurit duke respektuar tolerancat teknike, prerja e hekurit sipas përmasave të duhura duke eliminuar mbetjet (sa më pak firo), vendosjen e hekurit sipas specifikimeve të projektit, “mbjelljen” e kolonave në bashkëpunim me topografin ose inxhinierin e zbatimit, montimin (lidhjen) e hekurit sipas specifikimeve të përcaktuara, etj. Realizimi i punimeve të tilla lidhet me qëndrueshmërinë e të gjithë strukturës dhe duhet detyrimisht të realizohet nga punëtorë të kualifikuar.

Persa me siper kërkesa për 8 (tete) hekurkthyes është kërkesë e bazuar në raport me vëllimin e punës dhe grafikun e punimeve.

Gurepunues është i nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve të punimit të gureve për realizimin e mureve me gabiona, si pjese integrale e realizimit të zërave të punimeve ndërtimore, në përputhje me projektin dhe preventivin

-Punimet e ndërtimit dhe riparimit të murit të gurit për kanale me llaç çimento, kërkon specialiste gurepunues. Konkretisht për kryerjen e punimeve për zerat e punimeve të gurit në mbështetje të Manualit të ndërtimit miratuar me Vendim Nr. 216, datë 13.4.2023 *duhen gjithësej 6591 ore pune ose 824 dite pune 8 orarshe. Afati i punimeve është 5 muaj dhe kemi që për realizimin në afat të punimeve të gurit duhen 8 specialist gurepunues* Kërkesa për 8 (tete) gurepunues është minimale në raport me vëllimin e punës

Specialist për konstruksionet metalike - është i nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve të konstruksioneve metalike në objekt, sipas zërave të punimeve (Konstruksione metalike të perbera (porta)), në përputhje me projektin dhe preventivin Kërkesa që OE të ketë të punësuar minimalisht 1 (një) specialist për konstruksionet metalike, është kërkesë minimale në raport me vëllimin e punimeve.

Saldatori është i nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve të saldimit në sektore të ndryshme si në saldime në pranë uji për realizimin e vepres së marrjes së ujit si dhe në realizimin e konstruksioneve

metalike te perbera (porta) etj, si pjese integrale e realizimit te zërave te punimeve ndërtimore, në përputhje me projektin dhe preventivin

-Për saldimin e elementëve metalikë është kërkuar që të jene te punësuar një numër minimal saldatoresh 3 (tre) te certifikuar per punime speciale te saldimit sipas standartit SSH EN ISO 9606-1:2017. Punime të tilla duhet të realizohen me saktësi nga punëtorë të kualifikuar. Ky numër është minimal në raport me vëllimin e punës..

-Për saldimin e elementëve metalikë ne prani uji është kërkuar që të jene te punësuar një numër minimal saldatoresh 2 (dy) te certifikuar per punime speciale te saldimit sipas standartit UNI EN ISO 15618-1. Punime të tilla duhet të realizohen me saktësi nga punëtorë të kualifikuar. Ky numër është minimal në raport me vëllimin e punës..

Mekanik është i nevojshem për ndjekjen dhe realizimin e punimeve te F.V. Konstruksiione metalike te perbera (porta), si pjese integrale e realizimit te zërave te punimeve, në përputhje me projektin dhe preventivin

Per realizimin e ketyre punimeve është kërkuar që të punësuar një numër minimal prej 1 (nje) mekaniku. Punime të tilla duhet të realizohen me saktësi nga punëtorë të kualifikuar. Ky numër është shumë minimal në raport me vëllimin e punës.

Kopeshtare është i nevojshem për ndjekjen dhe realizimin e punimeve te Pastrim siperfaqe me bime te vogla,mbjelljen e fidaneve te pemeve dekorative ,si dhe kujdesjen per to per te gjithë periudhen e garancise . Duke patur parasysh qe kemi te bejme me pastrimin e nje siperfaqeje prej 4570m2 kërkesa që OE të ketë të punësuar minimalisht 5 (pese) punonjes kopeshtare, është kërkesë e diktuar nga vëllimi i punimeve dhe grafiku i shkurter i punimeve.

Percaktimi i numrit te punonjesve dhe profesionet eshte bazuar mbi zerat dhe volumet e punes si dhe afateve per perfundimin e punimeve, ne mbeshtetje te Manualit te ndertimit miratuar me Vendim Nr. 216, datë 13.4.2023.Bazuar ne kater elementet e struktures se kostos(material, puntori, makineri, transport).Numri i punonjësve, dhe profesionet që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore

- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht **7 punonjës manovratorë** të mjeteve të rënda (4 automakiniste dhe 3 eskavatoriste) dhe **3 shofere kamioni**.

Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmite e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse. (*Manovraret mund te disponohen se bashku me mjetet perkatese nese merren me qira*).

Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë per punonjesit eskavatoriste, automakinist dhe shofere, emer/mbiemer, profil i punes, numri dhe daten e kontratës individuale të punës, si dhe numrin dhe afatin e vlefshmerise se deshmise së aftësisë profesionale.

Shënim: Për pikën si më sipër, në fazën e ofertimit do të pranohet “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” sipas Shtojcës 8. Operatori ekonomik duhet të paraqesi dokumentacionin provues, sipas deklaratës së mësipërme, brenda 5 ditëve nga dërgimi i njoftimit për paraqitjen e tyre.

Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese punojesit e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kur mjetet janë marrë me qira nga persona fizik, të cilat janë në pronësi të këtyre të fundit, atehere manovraret, automakinistet dhe shoferet nuk ka nevojë që të figurojnë në listëpagesat përkatëse të O.E. ofertues.

Argumentim Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë

të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, sipas fushave që përfshijnë punimet për zbatimin e projektit.

Vendosja e këtij kriteri lidhet drejtpërdrejtë me mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës.

Për manovrimin e makinerive mbi bazë automjeti, ku përfshihen autobetoniere, autopompa betoni, dumper, grejder, rrul me vibrim është kërkuar kategoria e punonjësve të kualifikuar automakinst.

Kjo kërkesë mbështetet në kategorizimet e përcaktuara në Urdhërin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 200, datë 16.5.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”, neni 8, pika 1c që përcakton se, *automjete për përdorim të veçantë (APV) sipas pikës “g”, të nenit 54, të Kodit Rrugor, makineri ndërtimi mbi bazë automjeti:-autovinça, autobetonierë, autopompa betoni, autobitumatriçe, autosonda, autotokmak manovratorëve u jepet dëshmi për AUTOMAKINIST.*

Për manovrimin e autovinçit, vinc eskavator, vinc kulle duhet minimalisht nje automakinist, kjo duke bere nje alternim efeikas sipas programit të punës. Për manovrimin e dy autobetoniere, nje autopompe betoni dhe tre autobetoniere kantieri mjet teknologjik me targa, kerkohen minimalisht 2 automakiniste, pasi proceset e lidhura me këto automjete janë thuajse të njëkohëshme.

Përdorimi i makinerive dumper, grejder, rrul me vibrim dhe makinerise me kove “v” per kanalet, shtrim betoni, do të alternohet sipas programit të punës për zbatimin e kontratës. Prandaj per manovrimin e tyre duhen minimalisht nje automakinist.

Pra për manovrimin e të gjithë ketyre mjeteve janë kërkuar 4(kater) automakinistë. Ky numër automakinistësh është kërkuar minimal në raport me nevojat dhe grafikun e punimeve.

Për manovrimin e kamionëve vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton dhe 5-10 Ton

janë kërkuar 3 (tre) shofere. Ky numër shoferesh është kërkuar minimal në raport me nevojat, duke patur për qëllim rritjen e pjesëmarrjes

Për manovrimin e makinerive të gërmimit dhe ngarkimit të dherave ku përfshihen minifadromat dhe fadromat e llojeve të ndryshme dhe eskavatorët e ndryshëm janë kërkuar eskavatoristë.

Kjo kërkesë mbështetet në kategorizimet e përcaktuara në Urdhërin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 200, datë 16.5.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”, neni 8, pika 1a, sipas së cilës, *eskavator gërmimi e ngarkimi dherash:- të të gjitha llojeve si dhe fadromat e të gjitha llojeve (me goma dhe me zinxhirë), manovratorëve u jepet dëshmi për ESKAVATORIST.*

Për manovrimin e fadromes me goma me kovë para mbrapa, minifadromes dhe minieskavatorit eshte kërkuar gjithsej nje eskavatorist. Gjithashtu per punimet e gërmimit do të punojnë dy eskavatore me zinxhir me kove 1m3, dhe per punimet speciale jane dhe dy eskavatore, njeri eskavator me cekic dhe tjetri eskavator me zinxhir me hapje krahu mbi 21 m. Për këtë arsye do të nevojitet 2 (dy) eskavatoriste. Duke patur parasysh volumet e punes dhe duke alternuar përdorimin mjeteve sipas nevojave eshte e mjaftueshme kerkesa per 3 (tre) eskavatoristë

Kjo kërkesë është minimale në raport me punën e nevojshme. Kujtojmë se sipas nenit 17 të urdhrit më sipër cituar, *për të mundësuar lëvizjen në rrugë dhe për të shmangur aksidentet, mjetet për të cilat bën fjalë neni 8 i kësaj rregulloreje duhet të qarkullojnë në përputhje me përcaktimet e nenit 113 të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Ndërsa referuar nenit 8, pika 2, të po këtij akti, për lëvizjen apo qarkullimin në rrugë, makineritë e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, nëse janë të pajisura me rrota pneumatike, duhet të plotësojnë kërkesat e nenit 113 dhe 122 të Kodit Rrugor, kurse drejtuesit e tyre, në varësi të makinerisë, duhet të jenë të pajisur me kategorinë përkatëse të lejedrejtimit.*

4.8 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, per objektin qe prokurohet, te cilat duhet te jene te perkthyer ne gjuhen shqipe dhe te noterizuara, sipas standardeve:

- Çertifikate e cilësisë sipas Standartit **ISO 9001:2015 (per sistemin e menaxhimit te cilesise)**, e vlefshme, *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga te gjithë anetarët e BOE*
- Çertifikate e cilësisë sipas Standartit **ISO 14001:2015 (per sistemin e menaxhimit te**

mjedisit), e vlefshme, *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga te gjithë anetarët e BOE*

- Çertifikate e cilësisë sipas Standartit **ISO 45001-2018 (per sistemin e menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne pune),** ose certifikaten ekuivalente, e vlefshme, *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga te gjithë anetarët e BOE*
- Certifikatë **SSH/DIN/EN/UNI ISO 3834-2:2021,** (Sistemi i Menaxhimit të Cilesise ne Saldim), e vlefshme, ose ekuivalent. Certifikata te jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Certifikatë **EN 1090 (Ekzekutimi i strukturave prej çeliku dhe alumini),** e vlefshme, ose ekuivalent. Certifikata te jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

Ne rastin e bashkimit te perkohshem te shoqerive secili operator duhet te paraqese certifikatat e mesiperme, ne varesi te punimeve qe do te marri persiper konform marreveshjes.

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të vlefshme të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar), ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 - Që një subjekt të jetë i pajisur me certifikatën ISO 9001, do të thotë se ky subjekt ka plotësuar kërkesat e këtij standardi mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”. ISO 9001:2008 specifikon kërkesat për një sistem cilësor të menaxhimit të cilësisë, kur një organizatë:

- duhet të dëshmojë kapacitetin për të siguruar vazhdimisht produktin që kënaq klientin dhe kërkesat statutore dhe normative të aplikueshme.
- synon të përmirësojë kënaqjen e klientit, nëpërmjet aplikimit të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe garancisë të konformitetit me klientin dhe kërkesat statutore dhe normative të aplikueshme.

Me anë të kërkesës për paraqitjen e kësaj certifikate të 2008 ose të përditësuar, AK kërkon të vërtetojë se Oe ka kapacitetin për të garantuar konformitetin me kërkesat cilësore të tij.

ISO 45001 : 2018 - Rreziqet që lidhen me punën në kantier janë të shumta dhe janë shtjelluar në kriteret e mësipërme, si dhe në specifikimet teknike të projektit të zbatimit. Për këtë arsye, Ak duhet të sigurohet se Oe

zotëron kapacitetet për menaxhimin, kontrollin dhe parandalimin risqeve për sigurinë e jetës dhe shëndetit gjatë procesit të punës

Certifikata **ISO 45001 : 2018** dëshmon se subjekti plotëson kërkesat e paraqitura nga ky standard për identifikimin, kontrollin dhe zvogëlimin e risqeve, të lidhura me shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës.

ISO 14001:2015 - Sikurse vëren edhe VNM e pregatitur nga projektuesi, zbatuesi i punimeve duhet të marrë parasysh një sërë masash për zbutjen e efekteve negative në mjedis, si rezultat i zbatimit të punimeve për përmbushjen e kësaj kontrate. Të gjitha punimet e parashikuara në këtë procedurë duhet të kryhen në përputhje me specifikimet dhe dokumentacionin teknik të pregatitur nga projektuesi, duke respektuar legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e mjedisit.

Nga sa më sipër AK ka kërkuar që OE të paraqesë certifikatën ISO 14001:2015 (ose të përditësuar) për të dëshmuar kapacitetin për të kryer punimet në përputhje me rekomandimet e VNM, në konformitet me legjislacionin mjedisor në fuqi dhe standardet shtetërore dhe ndërkombëtare të menaxhimit mjedisor.

ISO 3834 – 2: 2021 - Objekti i kontratës përfshin punime ku saldimi përbën një proces të veçantë (special process), cilësia e të cilit nuk mund të verifikohet plotësisht vetëm nëpërmjet kontrollit përfundimtar të produktit. Në këto raste, cilësia duhet të garantohet gjatë vetë procesit të prodhimit dhe montimit, përmes procedurave të kontrolluara, personelit të kualifikuar dhe mbikëqyrjes teknike të vazhdueshme.

Për këtë arsye kërkohet që operatori ekonomik të zbatojë një sistem të certifikuar të menaxhimit të cilësisë së saldimit sipas SSH EN ISO 3834-2:2021.

Defektet në saldim mund të shkaktojnë dështime strukturore, rrjedhje, deformime dhe kosto të konsiderueshme riparimi. Certifikimi sipas SSH EN ISO 3834-2:2021 minimizon këto rreziqe duke garantuar kontroll sistematik të të gjithë procesit të saldimit.

ISO 1090 - Certifikata EN 1090 është e lidhur ngushtë me standarde të tjera teknike të përdorura në industrinë e ndërtimit metalik, si: ISO 3834, për menaxhimin e cilësisë në proceset e saldimit; ISO 9606-1, për kualifikimin e saldatorëve; ISO 14731, për koordinimin e saldimit.

Kombinimi i këtyre standardeve siguron një sistem të plotë për kontrollin e cilësisë gjatë fabrikimit dhe montimit të strukturave metalike. Zbatimi i këtij standardi garanton që elementet strukturore metalike prodhohen dhe montohen në përputhje me kërkesat teknike dhe të sigurisë të legjislacionit evropian.

4.9 Operatori Ekonomik duhet të disponojë:

a- Ne Pronesi / Kontrate Qeraje/ Kontrate Furnizimi, per Fabrike prodhimi i inerteve te pajisura me (Leje mjedisore, QKL Kodi III.1.B) e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Furnizusi te kete status aktiv ne QKB. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, dokumentat e mësipërme duhet ti paraqesë të pakten njeri nga anëtarët e grupit)

b- Ne Pronesi / Kontrate Qeraje/ Kontrate Furnizimi, per Fabrike prodhimi i betoni te pajisura me (Leje mjedisore, QKL Kodi III.1.B) e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Furnizusi te kete status aktiv ne QKB. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, dokumentat e mësipërme duhet ti paraqesë të pakten njeri nga anëtarët e grupit)

c- Kontrate furnzimi nga prodhuesi per hekur ose nga distributori e shoqeruar me autorizim prodhuesi, pajisur me ISO 9001- 2015 (Sistemi i Menaxhimit te Cilesise) e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Certifikata nga organizma kombetar ose nderkombetar sipas standarteve SSH EN 10080 :2005, SSH EN - ASTM A 510, SSH EN - ASTM A 615, dhe SSH EN DIN 488-2 per cilesine e hekurit.

d- Kontrate furnzimi per gur kave gurorje nga prodhuesi, ose nga distributori e shoqeruar me autorizim prodhuesi, e pajisur me leje mjedisore IV.1.B.2 “Leje minerare shfrytezimi per mineralin gur ranor pllakor”

e- Kontrate furnzimi per gabiona me rrjete teli te zinguar nga prodhuesi, ose nga distributori e shoqeruar me autorizim prodhuesi.

f- Kontrate furnzimi per fidane peme dekorative nga prodhuesi, ose nga distributori e shoqeruar me autorizim prodhuesi, e pajisur me certifikate fitosanitare

g- Kontrate Shërbimi me nje laborator testimi të materialeve kryesore të ndertimit beton, hekur, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombetar ose nderkombetar sipas standarteve SSH EN SSH EN 12350-2:2019, SSH EN 12504-2:2021, SSH EN ISO 6892 – 1:2019, SSH EN 12390-8:2019, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, dokumentat e mësipërme duhet ti paraqesë të pakten njeri nga anëtarët e grupit)

Kontratat e mesiperme duhet të jene me objektin e prokurimit dhe te përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Ne baze te nenit 77 te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik" dhe piken 8, te nenit 40, te VKM Nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", me ane te ketij kriteri AK gjykon se disponimi ne pronesi / me qera apo me kontrata furnizimi i ketyre fabrikave eshte nje dokumeut i rendesishem, pasi pervec se tregon origjinen e mallrave qe kerkohen ne procedure, garanton se ofertuesi eshte i garantuar per ofrimin tek Autoriteti Kontraktor te ketyre mallrave qe do te perdoren ne punimet e planifikuara. Kjo garanci lidhet njekohesisht edhe me treguesit cilesore te mallrave objekt prokurimi te cilat kerkohen qe te jene prodhuar ne perputhje me standardet dhe cilesite e kerkuara ne DST. Ky kriter eshte ne perpjestim me natyren dhe permasat e kontrates dhe lidhet drejtperdrejte me aftesite organizative, reputacionin dhe besueshmerine e OE ofertues per aftesite teknike. Kjo kerkese i sherben autoritetit kontraktor per njohjen e mundesise se OE per permbushjen me sukses te kontrates pasi sasia e produkteve qe do te perdoren eshte e konsiderueshme.

4.10 Operatori ekonomik duhet te kete në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion mjetet e pajisjet teknike te nevojshme per ekzekutimin e kontrates, si me poshte (sipas formularit permbledhes te vetedeklarimit):

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes deri 5-10 Ton	3 copë	Pronësi ose me qera
Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 20 Ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamioncine me kapacitet mbajtes 3.5 - 5 Ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion me vinc kapacitet mbajtes 3.5 - 7 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Autovinc	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhir me kove 1m3	2 copë	Pronësi ose me qera
Ekskavator me cekic	1 copë	Pronësi ose me qera
Vinc eskavator	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhir me hapje krahu mbi 21 m	1 copë	Pronësi ose me qera
Fadrom me goma me kove para mbrapa MT (mjet teknologjik me targa)	1 copë	Pronësi ose me qera
Minifadrom MT (mjet teknologjik me targa)	1 copë	Pronësi ose me qera
Minieskavator MT (mjet teknologjik me targa)	1 copë	Pronësi ose me qera
Grejder MT (mjet teknologjik me targa)	1 copë	Pronësi ose me qera
Dumper me kapacitet mbajtes mbi 25 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Rul (kompresor) me vibrim	1 copë	Pronësi ose me qera

Autobetonierë kantieri 2-3 m3 MT (mjet teknologjik me targa)	3 copë	Pronësi ose me qera
Vinc kulle	2 copë	Pronësi ose me qera
Vinc Karrel	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	2 copë	Pronësi ose me qera
Autopompe betoni	2 copë	Pronësi ose me qera
Makineri me kove “v” per kanalet, shtrim betoni	1 copë	Pronësi ose me qera
Betoniere kantieri 500 lit	3 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator betoni	3 copë	Pronësi ose me qera
Matrapik	2 copë	Pronësi ose me qera
Elektrosaldatriçe	2 copë	Pronësi ose me qera
Gazogjen	1 copë	Pronësi ose me qera
Skeleri	500m2	Pronësi ose me qera
Gjeneratore	1 copë	Pronësi ose me qera
Pllake vibruese	1 copë	Pronësi ose me qera
Pajisje per hekurkthyes (tranxhe,elektrobango)	1 copë	Pronësi ose me qera
Kapese per lidhje hekuri	2 copë	Pronësi ose me qera
Well Point per sisteme dranzhnimi	1 copë	Pronësi ose me qera

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 165 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5copë
- Uniforma/Jelek pune 165 cope
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 25 copë

a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

b) Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: kontrata përkatëse e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme, a) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) b) leje qarkullimi; c) çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme) ç) siguracion mjeti (i vlefshëm); d) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit per te trete dhe me qera (e vlefshme).

c) Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.

d) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme ne nje foto te vetme mjeti dhe targa e tij.

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruar në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruar nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk jane te deklaruar ne procedurat te shpallura fitues.

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi / qira / kontrate furniziki janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

- Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes deri 5-10 Ton cope 3

Gjithashtu për përcaktimin e numrit të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).

NR.	KODI	EMËRTIMI I PUNIMEVE.	NJËSIA	SASIA	ore pune /njesi Mjetet	Total ore pune Mjetet	MJETET
		1.VEPRA E MARRJES					
1	3.124/1a	Germim shkambi mesatar me çekiq me ekskavator me zinxhir 3	m3	2613	0.52	1,358.76	Ekskavator me cekic
2	3.25/a	Germim dheu me ekskavator zingjir 1.0 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, prani uji ~ 2m, kategoria IV, me shk ne toke (vepra)	m3	374	0.5	187.00	Ekskavator zinxhir 1.0 m³
3	3.211	Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri	m2	187	0.025	4.68	Grejder
					0.24	44.88	Rul (kompresor) me vibrim
4	3.245	Struktura monolite betoni C 25/30 (Dhemb I themelit te vepres marrjes	m3	60		-	Betonjere 500 liter; Vibrator thellesie

5	3.245	Struktura monolite betoni C 25/30 (Themeli i vepres marrjes)	m3	137.3		-	Betonjere 500 liter; Vibrator thellesie
6	3.245	Struktura monolite betoni C 25/30 (Muret e vepres marrjes)	m3	60.75		-	Betonjere 500 liter; Vibrator thellesie
7	3.245/1	Struktura te holla monolite betoni C 25/30	m3	43.45		-	Vibrator thellesie
8	3.288	F.V. Hekur betoni i zakonshem Ø > 12mm (vepra marrjes)	ton	6.44	0.63	4.06	Vinç kulle 0.5 - 1 ton
9	3.288	F.V. Hekur betoni i zakonshem Ø > 12mm (shpatullat)	ton	3.85	0.63	2.43	Vinç kulle 0.5 - 1 ton
10	3.352	Mbushje me gure kave D>1.5m	m3	195.6		-	
11	3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5.0 km	m3	2987		-	Autovetshkarkuese 5 km
2.PUNIME GERMIMI DHE SISTEMIMI							
1	3.109/b	Germim dheu me ekskavator zingjir 1.0 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, prani uji ~ 2m, kategoria IV, me shk ne toke	m3	8940.15	0.039	348.67	Ekskavator zinxhir 1.0 m³
2	3.109/b	Germim dheu me ekskavator zingjir 1.0 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, prani uji ~ 2m, kategoria IV, me shk ne toke (Hapje trase)	m3	6088	0.039	237.43	Ekskavator zinxhir 1.0 m³
3	3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5.0 km	m3	15028.14		-	Autovetshkarkuese 5 km
4	3.4	Prerje e sistemim pemesh ø 21 ~ 40 cm	copë	575		-	
5	3.961	F.V. Fidane Peme dekorative	copë	44		-	
SHUMA 2:							
3.PUNIME MBUSHJE							
1	3.396/1	Mbushje me zhavorr lumi (Kanali)	m3	9641.54	0.04	385.66	Fadrom
2	3.352	Mbushje me gure kave t=2ton/m3 ne blloqe,D=0.8-1.2	m3	1650.0		-	
SHUMA 3:							
4.PUNIME BETONI PER ARGJINATUREN DHE KANALIN							
1	2.258	Nenshtrese zhavori per kanal in t=20CM	m3	3196.8		-	
2	3.243/1	Blloqe beton per Themelin C-16/20	m3	4113.2		-	Betonjere 500 liter; Vibrator thellesie
3	3.244/1	Struktura te holla monolite betoni C 20/25 per kanal in t=20cm	m3	3196.8		-	Vibrator thellesie

4	3.245/1	Struktura te holla monolite betoni C 25/30 (Pellgu ujembledhes)	m3	209		-	Betonjere 500 liter; Vibrator thellesie
5	2.166	F.V. Hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm (Pellgu ujembledhes)	ton	3.87	0.63	2.44	Vinc kulle 6 - 10 ton, kamion
6	2.166	F.V. Hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm (kanali)	ton	104	0.63	65.52	Vinc kulle 6 - 10 ton, kamion
7	3.288	Hekur per kapje blloqe betoni	ton	3	0.63	1.89	Vinç kulle 0.5 - 1 ton
8	3.331	Gabiona me rrjete teli te zinguar e gure kave 1x1x1 m	m3	20.00		-	
9	3.333	Gabiona me rrjete teli te zinguar, gure kave 1x1x2 m	m3	40.00		-	
10	2.181	F.V. Konstruksione metalike te perbera (porta)	ton	1.00		-	Saldatrice elektrike;Gazogjen ;Autovinc deri 2.5 ton;Vinc eskavator;Skele

Argumentimet per secilin mjet dhe pajisje jane si me poshte :

-Kamionët vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton janë makineri të rënda të projektuara posaçërisht për të transportuar dhe shkarkuar me shpejtësi volume të mëdha materialesh të lira në terrene të vështira. Detyra e tyre kryesore është të lëvizin ngarkesa masive që kamionët e thjeshtë nuk i përballojnë dot. Këto mjetë do të shërbejnë për të realizuar punimet e transportit të inerteve ,materialeve qe kane dale nga germimet ,transportin e cakullit mbeturine kave,gurit kave si dhe mbushjes me zhavorr lumi sipas sasive qe permbajne zerat e punimeve ne preventive .Kerkesa per disponimin e dy kamioneve lidhet me sasine e madhe te materialeve qe do transportohen referuar preventivit te punimeve si dhe kerkesen per realizimin e punimeve brenda afatit te parashikuar ne grafikun e punimeve.

-Kamionçinat me kapacitet mbajtës 3.5 deri në 5 ton shërbejnë si mjeti kryesor për transportin e mallrave në distanca të shkurtra dhe të mesme në kantierin e ndërtimit ku hapësira është e kufizuar dhe rrugët janë të ngushta. Transporti i materialeve të imta sic jane transporti i sasive të vogla të zhavorrit ,gurit kave gabionave me rrjete teli te zinguar si dhe hekuri në rrugica ku kamionët e mëdhenj 20-tonësh nuk mund të hyjnë dot. Kërkesa për disponimin e dy kamioncinave lidhet me sasine e madhe te materialeve qe do transportohen referuar preventivit te punimeve si dhe kerkesen per realizimin e punimeve brenda afatit te parashikuar ne grafikun e punimeve.

-Kamionët me vinç me kapacitet mbajtës 3.5 deri në 7 ton shërbejnë si mjet për ngarkim-shkarkim autonom dhe transport pa pasur nevojë për një ekskavator apo pirun shtesë. Kapaciteti i ngritjes së vinçit përdoren kryesisht për të automatizuar punën e rëndë fizike në zona ku hapësira nuk lejon përdorimin e makinerive të mëdha. Ngritja dhe pozicionimi i kolonave të hekurit, kallepeve metalike si dhe materialeve te tjera.sic jane fidane peme dekorative e kerkojne domosdoshme .

-Autovinçi shërben për të kryer procese kritike me një mjet të vetëm: ngritjen ose zhvendosjen e peshave të rënda, autovinçi ka avantazhin e madh të lëvizshmërisë – ai mund të udhëtojë në rrugë publike si një kamion normal dhe të operojë kudo ku ka hapësirë për t'u parkuar.Ne rastin konkret ai do te sherbeje per transportin e hekurit dhe shkarkimin e tij

-Eskavator me zinxhir me kove 1 m3 eshte i nevojshem për thellimin e trupit te vepres se marrjes dhe te kanalit vadites si dhe per germimin e themeleve per ndërtimin e argjinaturave kundër përmytjeve.Gërmimi i themeleve te vepres se marrjes ,hapja e kanalit vadites , nivelimi i dherave ,shpërndarja dhe nivelimi i volumeve të mëdha të dheut për e rruges e aksesit ,mbushja e kamionëve me material . Kjo kovë është krijuar posaçërisht për të mbushur me shpejtësi kamionët vetëshkarkues mbi 20 ton . Sherben per punimet ne objekt si lëvizja e inerteve ,pastrimi i zonave të egra, shkulja e rrënjëve të mëdha të pemëve, thyerja e shkëmbinjve sipërfaqësorë dhe largimi i mbetjeve nga kantieri.,pastrimi i shtretërve të lumenjve: Zinxhirët e çelikut e lejojnë të punojë brenda në ujë apo në baltë pa u fundosur (ndryshe nga ekskavatorët me goma). Kërkesa për disponimin e dy eskavatoreve me zinxhir lidhet me sasine e madhe te materialeve qe do germohen qe jane rreth 10000 m3

referuar preventivit te punimeve si dhe kerkesen per realizimin e punimeve brenda afatit te parashikuar ne grafikun e punimeve

- **Eskavatori me çekik** shërben për thyerjen, copëtimin dhe shkatërrimin e materialeve jashtëzakonisht të forta të cilat kova standarde nuk mund t'i gërmojë dot. Ky mjet është i domosdoshëm referuar zerit te punimeve ne preventive me nr.3.124/1a "Gërmim shkëmbi mesatar me çekik me eskavator me zinxhir " ne sasine 2613 m³ .

- **Eskavator Hidraulik i Përdorur si Vinç** do te përdoret për të ngritur dhe zhvendosur objekte të rënda në distanca të shkurtra brenda kantierit ku një vinç normal nuk mund të hyjë (ulja e zgarave te hekurit , zhvendosja e blloqeve të gurit ose makinerive të tjera të vogla).

-**Eskavator me krahe te gjate 21 ml** është projektuar posaçërisht për gërmime , pastrime dhe rreze të gjerë veprimi, aty ku një eskavator standard nuk mund të afrohet për shkak të terrenit të rrezikshëm ose të butë. Gërmimi i shtratit të lumit Shkumbin per krijimin e themeleve te vepres se marrjes , devijimi i shtratit te lumit per te mundesuar ndertimin e argjinatures mbrojtese e cmonte nevojshme disponimin e nje mjeti te tille .Aftesia e ketij Eskavatori me krahe te gjate 21 m është domosdoshëm sepse ai qëndron i sigurt në breg dhe arrin të pastrojë aluvionet, rërën dhe mbetjet deri në mesin e shtratit të lumit Shkumbin pa pasur nevojë të hyjë brenda në ujë.

-**Fadrome me kove para dhe mbrapa** është një mjet që do te shërbeje per ngarkim inertesh, dhera, rërë, zhavorr apo mbetje ndërtimi nëpër kamionçina (3.5 - 7 ton) ose kamionë. Ky mjet shërben per nivelim terreni pasi kova e përparme përdoret për të shtyrë, rrafshuar dhe niveluar dherin ose stabilizantin nëpër rrugë e kantiere ndersa me krahun e pasmë shërben per hapje kanalesh, Gërmon kanale të sakta ne zbatim te zerave te punimeve si dhe realizon punë precize: Krahu i pasmë mund të lëvizë në kënde të ngushta, duke punuar shumë afër mureve të shtëpive pa i dëmtuar ato.

Kerkohet qe ky mjet te jete i pajisur me targa nisur nga fakti se sëse gjatë punës ose lëvizjes mund te goditet gabimisht një makinë tjetër apo dëmtohet një pronë, dhe **siguracioni mbulon dëmet**. Pa targa dhe pa siguracion, të gjitha dëmet duhet t'i paguaj investori kundrejt te demtuarit . Ky mjet është i nevojshëm ne baze te nr.3.396/1 te zerit te punimeve "Mbushje me zhavorr lumi (kanali)" .

-**Minifadrom** është një makineri ndërtimi e përmasave shumë kompakte me rrota gome ose mini-zinxhirë. Ajo ka aftësinë unike për t'u rrotulluar 360 gradë rreth vetes në vend , gjë që e bën mjetin më efikas në hapësira jashtëzakonisht të ngushta ku asnjë makineri tjetër nuk hyn dot. Është shumë e domosdoshme per te levizur dhe punuar brenda kantierit me shpejtesi dhe pa pengesa . Kerkohet qe ky mjet te jete i pajisur me targa nisur nga fakti se sëse gjatë punës ose lëvizjes mund te goditet gabimisht një makinë tjetër apo dëmtohet një pronë, dhe **siguracioni mbulon dëmet**. Pa targa dhe pa siguracion, të gjitha dëmet duhet t'i paguaj investori kundrejt te demtuarit .

- **Minieskavator me zinxhire** është një makineri gërmimi me saktësi të lartë në hapësira të kufizuara. Për shkak të zinxhirëve prej gome ose çeliku , ai ka një stabilitet të shkëlqyer, nuk e dëmton sipërfaqen mbi te cilen leviz , dhe mund të kalojë në terrene me baltë pa u bllokuar. Nisur nga fakti se terreni ku do te kryhen punimet është ne shtratin e lumit disponueshmeria e tij cmohet e domosdoshme per te realizuar punimet me cilesi dhe ne kohe. Kerkohet qe ky mjet te jete i pajisur me targa nisur nga fakti se nëse gjatë punës ose lëvizjes goditni gabimisht një makinë tjetër apo dëmtoni një pronë, **siguracioni mbulon dëmet**. Pa targa dhe pa siguracion, të gjitha dëmet duhet t'i paguaj nga investori kundrejt te demtuarit

-**Grejder** është një makineri e rëndë dhe shumë specifike ndërtimi, e cila shërben kryesisht për nivelimin përfundimtar me saktësi maksimale të sipërfaqeve të dherave, zhavorrit , grejderi ka një thikë të gjatë dhe të lëvizshme të montuar poshtë shasisë (midis aksit të parë dhe të pasmë). Kjo thikë mund të rrotullohet, të anohet dhe të lëvizë majtas-djathtas për të prerë dhe rrafshuar tokën me saktësi milimetrike . Kerkohet qe ky mjet te jete i pajisur me targa nisur nga fakti se sëse gjatë punës ose lëvizjes mund te goditet gabimisht një makinë tjetër apo dëmtohet një pronë, dhe **siguracioni mbulon dëmet**. Pa targa dhe pa siguracion, të gjitha dëmet duhet t'i paguaj investori kundrejt te demtuarit . Ky mjet është i nevojshëm ne baze te nr.3.211 te zerit te punimeve "Shtrese cakulli mbeturine kave t=20cm" , perhapur e ngjeshur me makineri"

-**Dumper-at** me kapacitet mbajtës mbi 25 ton janë makineri vetëshkarkuese të projektuara ekskluzivisht për te qarkulluar ne terrene të vështira, shtrate lumenjsh ,rruge me balte dhe nen uje .

Edhe nëse rrugët e kantierit janë të mbuluara me baltë të thellë, këta dumper-a nuk ngecin kurrë dhe mund të ngjisin pjerrësi shumë të mëdha duke transportuar 30-40 ton material. Kerkohet qe ky mjet te jete i pajisur me targa nisur nga fakti se nëse gjatë punës ose lëvizjes goditni gabimisht një makinë tjetër apo dëmtoni një pronë, **siguracioni mbulon dëmet**. Pa targa dhe pa siguracion, të gjitha dëmet duhet t'i paguaj nga investori kundrejt te demtuarit.

-**Rruli me vibrim** është një makineri e rëndë ndërtimi, e cila shërben për ngjeshjen (kompaktimin) e dherave, zhavorrit, stabilizuesit. Qëllimi kryesor i këtij mjeti është të largojë xhepat e ajrit dhe lagështirën nga shtresat e tokës ose materialit, duke krijuar një bazament super të fortë dhe të qëndrueshëm që nuk ulet apo dëmtohet kur

sipër tij të kalojnë makinat e rënda. Ky mjet është i nevojshëm në baze të nr.3.211 të zërit të punimeve "Shtrese cakulli mbeturine kave $t=20\text{cm}$, përhapur e ngjeshur me makineri"

- **Autobetonieret e kantierit me kapacitet 2 deri në 3 m³** , janë makineri kompakte dhe inteligjente ndërtimi. Ndryshe nga betonieret e mëdha këto mjete janë një "fabrikë lëvizëse betoni". Ato kanë aftësinë të ngarkojnë vetë materialet (rërën, zhavorrin, çimenton), t'i përziejnë me ujë brenda treguesit (tamburit) dhe ta prodhojnë betonin e freskët direkt në vendin e punës. Kapaciteti prej 2-3 metër kub (m³) është ideal për rastet ku sasia e betonit duhet të menjehershme por jo në volume gjigande, ose ku fabrikat e mëdha të betonit ndodhen shumë larg dhe ideale për betonimin e kanaleve të gjata vaditëse .

- **Vinc kulle** shërben për të ngritur dhe pozicionon sistemet e dërrasave apo paneleve të metalit (kallepeve) ku do të hidhet betoni i kollonave dhe sofiteve.

- **Vinc Karrel** është një makineri që kombinon strukturën dhe manovrueshmërinë e një piruni (karrel) me krahun teleskopik të një vinçi.

Avantazhi i tij më i madh është se krahun e tij nuk lëviz vetëm lart e poshtë, por zgjatet përpara në distancë, duke çuar materiale aty ku një pirun standard nuk arrin dot.

- **Autobetoniere** shërben për transportin e kontrolluar dhe ruajtjen e cilësisë së betonit të freskët nga fabrika ku prodhohet (pika e betonit) deri në kantierin ku do të hidhet .

Detyra e saj kryesore nuk është thjesht lëvizja e materialit, por mbrojtja e tij që të mos ngurtësohet dhe të mos humbasë vetitë inxhinierike gjatë rrugës.

- **Autopompa e betonit** shërben për të marrë betonin e freskët nga autobetoniere (dhe për ta **transportuar atë me presion të lartë në lartësi, në thellësi ose në distanca të gjata** .

- **Makineria me kovë në formë "V" për kanalet ose ekskavator me kovë trapezoidale** . Ajo nuk është një makineri e veçantë më vete, por është një aksesori kovë specifike që montohet në majë të krahut të çdo ekskavatori standard ose mini-ekskavatori. Dizajni i saj unike—i gjerë në krye dhe i ngushtë në fund—është krijuar ekzaktesisht për të gërmuar profile kanalesh me skarpata (shpatet anësore) të prera në mënyrë perfekte në një kalim të vetëm. Është mjeti kryesor në fushën e bujqësisë për të hapur kanale të gjata uji nëpër parcela pa rrezikuar që muret e kanalit të shemben pas gërmimit.

- **Betoniere kantieri 500 lt.** Kapaciteti prej 500 litrash i referohet vëllimit total të tamburit, që do të thotë se sasia e betonit të gatshëm që nxjerr në çdo përzierje (cikël) është rreth 300 deri në 350 litra (pasi materiali nuk mund të mbushet deri në buzë që të mos derdhet gjatë rrotullimit).

Kjo betonierë plotëson nevojat e kantierëve ku makinat e mëdha të betonit nuk mund të hyjnë, ose ku hidhen sasi të vogla betoni ditë pas dite:

- **Vibrator betoni** shërben për ngjeshjen dhe eliminimin e fluskave të ajrit nga betoni i freskët menjëherë pasi ai hidhet në kallëp.

Ky është një nga pajisjet më kritike për sigurinë strukturore të një veprë. Pa përdorimin e vibratorit, betoni mbetet poroz , gjë që e bën strukturën të dobët dhe të rrezikshme për t'u shembur në rast tërmeti.

- **Matrapiku** (shërben për thyerjen, çarjen dhe shkatërrimin e materialeve shumë të forta si betoni, dhe shkëmbinjë. Në kantier, ky mjet plotëson detyrat e thyerjes në ato zona ku nuk mund të hyjë një ekskavator me piko hidraulike (për të cilin folëm më lart), duke u kthyer në mjetin kryesor të punës me dorë për demolime

- **Elektrosaldatrice** . Është një pajisje elektrike që shërben për bashkimin e përhershëm të dy ose më shumë pjesëve metalike (si hekuri, çeliku,). Saldimi i shufrave të mëdha të hekurit për të krijuar kafaze të fortë strukturore përpara se të hidhet betoni.

- **GAZOGJEN** Përdoret për të prerë me saktësi shufrat e hekurit apo shufrat e trashë të armaturës që nuk mund të priten me disk fresibël.

- **SKELERI 500 M2** Skeleri në punimet e betonit , i njohur ndryshe në gjuhën teknike si sistemi i kallepeve mbështetëse ose skela mbajtëse) shërben si struktura e përkohshme metalike që mban peshën masive të betonit të freskët dhe të hekurit përpara dhe gjatë procesit të ngurtësimit . Skeleri në punimet e betonit është i projektuar për të përballuar presion dhe ngarkesa shumë të larta strukturore [stem-calculative-problem-solvi

- **Gjeneratori** në kantieret e ndërtimit shërben si burimi parësor ose rezervë i energjisë elektrike, i cili kthen energjinë mekanike (të prodhuar nga një motor me naftë ose benzinë) në energji elektrike. Është pajisja e parë që vendoset në një kantier të ri ndërtimi për të garantuar pavarësi të plotë energjetike përpara se objekti të lidhet zyrtarisht me rrjetin elektrik kombëtar. Gjeneratori furnizon me korrent një numër të madh makinerish dhe mjetet që kemi diskutuar në bisedat e mësipërme: Furnizimi i Makinerive të Rënda: Ndezja dhe vënia në punë e vinçave kullë, pompave statike të betonit, makinerive të pilotave dhe ashensorëve të jashtëm të kantierit. Veglat e Punës me Dorë: Mundëson përdorimin e pandërprerë të matrapikëve elektrikë, aparateve të saldimit

(elektrosaldatrice), vibratorëve të betonit, fresiblave dhe trapanëve. Ndrëimi i Kantierit: Furnizimi i projektorëve të mëdhenj LED që lejojnë punën gjatë natës ose nëpër hapësira të mbyllura pa dritë natyrore (si tunele apo garazhe nëntokësore).

Infrastruktura e Kantierit: Mbajtja në punë e zyrave të përkohshme të inxhinierëve (kontenierëve), sistemeve të kondicionimit, kompjuterave dhe pompave që largojnë ujin nga gropat e themeleve

-Pllaka vibruese shërben për **ngjeshjen dhe stabilizimin e dherave, zhavorrit, në sipërfaqe të vogla ose të ngushta**.

-Pajisjet për hekurthyes (ose Tranxhat e hekurit) janë makineritë dhe veglat kryesore profesionale që përdoren në kantier për prerjen, përkuljen dhe formësimin e shufrave të çelikut (armaturës) përpara se të bëhet betonimi

-Kapësja për lidhje hekuri shërben për lidhjen automatike dhe ultra të shpejtë të shufrave të çelikut me tel përpara se të hidhet betoni.

Ky mjet me bateri ka zëvendësuar pothuajse plotësisht pincat tradicionale të dorës në kantieret moderne. Operatori thjesht e mbështet kokën e pajisjes në kryqëzimin e dy shufrave të hekurit, shtyp butonin, dhe mjeti brenda më pak se 1 sekonde kalon telin, e pret atë, dhe e shtrëngon me një të përsosur.

-Sistemi i drenazhimit Wellpoint shërben për uljen e përkohshme të nivelit të ujërave nëntokësore në kantiere ndërtimi, duke lejuar gjurmimin e sigurt dhe betonimin e themeleve në kushte plotësisht të thata. Ky sistem është absolutisht i pazëvendësueshëm në Shqipëri kur gjurmohet pranë shtretërve të lumenjve,

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Grafikon e punimeve në përputhje me zërat e punës të jetë në përputhje me afatin kohor në dokumentet e tenderit, kjo në respektim të Vendimit Nr. 914 datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kjo kërkesë është bërë në bazë të nenit 15 pika 3/a të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku parashikohet: “*Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën: - grafikun e zbatimit;*”

Bazuar në parashikimet e Rregullave të Prokurimit Publik, miratuar me VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku në pikën 6 të nenit 26 parashikohet: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Ofertuesi i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin e parashikuar në pikën 6 të nenit 26 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 të ndryshuar, brenda afatit 5 ditor që ka në dispozicion autoriteti kontraktor, për publikimin e njoftimit të fituesit, sipas nenit 97/1 të LPP-së.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për s'kualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Bazuar në dokumentacionin e projektit objekt prokurimi, ku ndër të tjerash janë dërguar dhe Specifikimet Teknike për punimet që do të kryhen, të cilat janë hartuar nga një shoqëri e licensuar në projektim, duke qënë se këto specifikime teknike plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 të ligjit **nr.162/2020, datë 23.12.2020** “Për Prokurimin publik”, dhe nenin 39 pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave **Nr. 285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), njësia e prokurimit kreu miratimin e specifikimeve teknike për punimet objekt prokurimi.

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.

NJËSIA E PROKURIMIT

